



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË  
DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV – MSc.

2018 – 2021

**Pasqyra e programit: MSc Konstruktiv**

| <b>Viti i Studimit: I</b> |            |                                      |          |          |             |   |
|---------------------------|------------|--------------------------------------|----------|----------|-------------|---|
| <b>Semestri: I</b>        |            |                                      |          |          |             |   |
| <b>Nr.</b>                | <b>O/Z</b> | <b>Lënda</b>                         | <b>L</b> | <b>U</b> | <b>ECTS</b> | <b>Emri i Mësimdhënësit</b>                             |
| 1                         | O          | Metodologjia hulumtuese kërkimore    | 2        | 1        | 3           | Dr.Sc. Ragip Hadri                                      |
| 2                         | O          | Strukturat metalike                  | 2        | 2        | 6           | Mr.Sc.Faik Hasani, ligjerues                            |
| 3                         | O          | Konstruksionet e betonit             | 2        | 2        | 6           | Prof ass dr. Kadri Morina,<br>Ass Mr.sc. Vlora Shatri   |
| 4                         | O          | Menaxhimi i projekteve *             | 2        | 0        | 3           | Dr.Sc. Ilir Rodiqi                                      |
| 5                         | Z          | Strukturat prej druri të lameluar *  | 2        | 2        | 6           | Prof.ass.dr.Florim Grajcevc                             |
| 6                         | Z          | Materialet polimere dhe bituminoze * | 1        | 1        | 3           | Prof.dr.Naser Kabashi                                   |
| 7                         | Z          | Metodat matematikore ne Inxhinieri * | 2        | 1        | 3           | Prof.dr.Abdullah Zejnullahu                             |
| 8                         | Z          | Metodat e elementeve te fundme       | 2        | 1        | 3           | Prof.asoc.dr.Misin Misini                               |
| 9                         | Z          | Pllakat dhe Guaskat                  | 3        | 2        | 6           | Prof.dr.Musa Stavileci<br>Prof asoc. dr. Misin Misini   |
| 10                        | Z          | Gjuhë Angleze teknike I *            | 2        | 0        | 3           | Festa Shabani, lek                                      |
| 11                        | Z          | Gjuhë gjermane teknike I             | 2        | 0        | 3           | Prof. ass. dr. Milote Sadiku                            |
| Totali                    |            |                                      |          |          | 30          |   |
| <b>Semestri: II</b>       |            |                                      |          |          |             |   |
| <b>Nr.</b>                | <b>O/Z</b> | <b>Lënda</b>                         | <b>L</b> | <b>U</b> | <b>ECTS</b> | <b>Emri i Mësimdhënësit</b>                             |
| 1                         | O          | Menaxhimi i Ndërtimit *              | 2        | 2        | 6           | Dr. sc. Ilir Rodici                                     |
| 2                         | O          | Dinamika e Strukturave               | 3        | 2        | 6           | Prof.dr.Musa Stavileci<br>Prof asoc. dr. Misin Misini   |
| 3                         | O          | Urat                                 | 3        | 0        | 6           | Dr. sc. Cene Krasniqi                                   |
| 4                         | Z          | Elementet e parapergaditura nga BA   | 2        | 1        | 3           | Prof ass dr. Kadri Morina,<br>Ass Mr.sc. Bajram Shefkiu |
| 5                         | Z          | Betoni i Paranderur                  | 2        | 2        | 6           | Prof ass dr. Kadri Morina,                              |

|        |   |                                 |   |   |    |  |
|--------|---|---------------------------------|---|---|----|--|
|        |   |                                 |   |   |    | Ass Mr.sc. Bajram Shefkiu                          |
| 6      | Z | Strukturat e lehta Metalike     | 2 | 1 | 3  | Mr.sc.Faik Hasani,ligj.larte<br>Mr. sc. Ali Muriqi |
| 7      | Z | Teoria e Plasticitetit          | 2 | 1 | 3  | Prof.asoc.dr.Misin Misini                          |
| 8      | Z | Analiza Jolineare e Strukturave | 2 | 1 | 3  | Dr. sc. Ragip Hadri                                |
| 9      | Z | Stabiliteti i Strukturave       | 2 | 1 | 3  | Prof.asoc.dr.Fatos Pllana                          |
| 10     | Z | Gjuhë angleze teknike II *      | 2 | 0 | 3  | Festa Shabani, lek                                 |
| 11     | Z | Gjuha Teknike Gjermane II       | 2 | 0 | 3  | Prof. ass. dr. Milote Sadiku                       |
| Totali |   |                                 |   |   | 30 |  |

**Sqarim:** Numri total i kredive (ECTS) të akumuluarua për një vit është 60 ECTS – kredi.

Nga 7 lëndët obligative fitohen gjithsej 36 ECTS, nga 7 lëndë zgjedhore studenti është i obliguar ti zgjedh 4 lëndë, gjegjësisht 24 ECTS – kredi, ose 5 lëndë, gjegjësisht me 24 ECTS – kredi, ose 6 lëndë, gjegjësisht 24 ECTS – kredi dhe ose 8 lëndë, gjegjësisht 24 ECTS – kredi.

**Pas zgjedhjes së lëndës zgjedhore ajo shndërrohet në lëndë obligative, studenti nuk do të mund ta ndërroj lëndën dhe as Profesorin.**

| <b>Viti i Studimit: II</b> |     |  |   |   |      |   |
|----------------------------|-----|--|---|---|------|---|
| <b>Semestri: III</b>       |     |  |   |   |      |   |
| Nr.                        | O/Z | Lënda  | L | U | ECTS | Emri i Mësimdhënësit                                  |
| 1                          | Z   | Projektimi i strukturave nga betoni i armuar | 2 | 3 | 6    | Prof ass dr. Kadri Morina,<br>Ass Mr.sc. Vlora Shatri |
| 2                          | Z   | Shqyrtimet e strukturave *                   | 2 | 2 | 6    | Prof. dr.Naser Kabashi                                |
| 3                          | Z   | Projektimi i urave metalike                  | 1 | 3 | 6    | Mr. sc. Faik Hasani ligj.<br>Mr.Sc. Ali Muriqi        |
| 4                          | Z   | Projektimi i urave te betonit                | 2 | 3 | 6    | Dr.sc.Cene Krasniqi                                   |
| 5                          | Z   | Bazat e inxhinierise se tërmeteve *          | 2 | 2 | 6    | Prof.asoc.dr.Misin Misini                             |
| 6                          | Z   | Ndertesat e larta *                          | 2 | 2 | 6    | Prof.ass.dr.Florim Grajçevci<br>Mr. Sc. Ali Muriqi    |
| 7                          | Z   | Sanimi i strukturave ekzistuese*             | 2 | 2 | 6    | Prof.dr.Naser Kabashi                                 |
| 8                          | Z   | Strukturat murature*                         | 2 | 2 | 6    | Prof.ass.dr.Florim Grajçevci                          |
| 9                          | Z   | Karakteristikat reologjike të betonit        | 2 | 0 | 3    | Prof.ass.dr.Hajdar Sadiku                             |
| 10                         | Z   | Fondimet e vecanta*                          | 2 | 1 | 3    | Dr. sc. Qani kadiri                                   |
| 11                         | Z   | Ekonomia e ndërtimit*                        | 2 | 1 | 3    | Dr. sc. Ilir Rodici                                   |

|                     |            |               |          |          |             |                             |
|---------------------|------------|---------------|----------|----------|-------------|-----------------------------|
|                     |            |               |          |          |             | Dr. sc. Esat Gashi          |
| Totali              |            |               |          |          | 30          |                             |
| <b>Semestri: IV</b> |            |               |          |          |             |                             |
| <b>Nr.</b>          | <b>O/Z</b> | <b>Lënda</b>  | <b>L</b> | <b>U</b> | <b>ECTS</b> | <b>Emri i Mësimdhënësit</b> |
| 1                   | O          | Punim Diplome |          |          | 30          |                             |
| Totali              |            |               |          |          | 30          |                             |

**Sqarim:** Numri total i kredive (ECTS) të akumuluarra për një vit është 60 ECTS – kredi.

Nga **0** lëndët obligative fitohen gjithsej **0** ECTS, nga **10** lëndë zgjedhore studenti është i obliguar ti zgjedh **5** lëndë, gjegjësisht **30** ECTS – kredi. Ndërsa ne semestrin e katërt studenti obligohet të punoj punimin e diplomës e cila përmban 30 ECTS.

**Pas zgjedhjes së lëndës zgjedhore ajo shëndrohet në lëndë obligative, studenti nuk do të mund ta ndërroj lëndën dhe as Profesorin.**

\*Lendet / Modulet te cilat do te mbahen ne Gjuhen Angleze

## **Përshkrimi i modulit/lëndës**

### **METODOLOGJIA HULUMTUESE KERKIMORE**

**Përmbajtja:** Grumbullimi, studimi dhe sistematizimi i informatave. Kuptimi, llojet dhe vërtetimi i hipotezave. Kuptimi, qëllimi dhe elementet karakteristike të punëve seminarike. Grumbullimi i shënimeve. Analiza e shënimeve. Metodatat e punës hulumtuese. Metoda e modelimit. Metoda statistikore. Metoda matematikore. Metoda eksperimentale. Teoria e lidhjeve si metode. Metoda e studimit të rastit. Metoda vizuale. Metoda e anketimit dhe intervistave. Menyra e prezantimit të rezultateve. Metoda Delfi. Citimi i literaturës. Bibliografia.

**Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit::** Pas kompletimit të kursit kandidatët do të jenë në gjendje që të shkruajnë raporte të ndryshme tekste të ndryshme dhe do të jenë në gjendje të plotë në aspektin narrativ një pune shkencore duke përfshirë dhe punimin e Masterit. Studenti përgadite punimin e diplomes, forma të metodologjive kërkimore, punimeve shkencore.

**Format e mesimdhënies dhe mesim nxënies:**Prezantimi i ligjeratave me kompjuter dhe projektor, shpjegime në tabele, bashkëpunimi i mesimdhënesit me studentin gjatë kohës së ligjerimit përkatësisht ushtrimeve të shembujve të rastëve të ndryshme të punimeve. Krahasimi dhe vlerësimi i punimeve të ndryshme, rritja e performancës të hartimit të një punimi. Para fillimit të çdo ligjerate përsëritje me studentet për shtjellimet paraprake. Brenda kohës prej 15 javë mesimi organizohet dy kolokiume si teste të nxënies dhe të njëjtat kanë ndikim në vlerësimin përfundimtar.

**Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:**Dy nga kolokiumet vlerësohen (15+15)=30%, Punimi semestral vlerësohet me 30%, Prezenca në ligjerata dhe ushtrime 10%, prezantimi i punimit 10%, pjesa teorike e testit vlerësohet 20%. Kalueshmëria e studentit vlerësohet në përqindje, në varesi nga nxënia gjatë zhvillimit të lëndës. Vlera më e madhe se 50% është rezultat pozitiv.

### **Mjetet e konkretizimit/TI;**

Tabela, kompjuter, tavolina pune, projekte të ndryshme.

### **Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit**

| Pjesa teorike | Pjesa praktike |
|---------------|----------------|
| 60 %          | 40 %           |

**Literatura bazë:** Zelenika R. Methodology and technology prepared the research work, Rijeka 1999; Fellows, R.; Liu, A. Research Methods for Constructions, Oxford: The Blackwell Science, 1997; Holt, D.G.: A guide to successful dissertation study for students of the built environment.

## STRUKTURAT METALIKE

**Përmbajtja:** Hyrje , historiku i ndërtesave të larta metalike në përgjithësi. Zgjedhja e formës së bazës të ndërtesave të larta; Themelet të ndërtesave të larta në formë pllake të rrafshme, pllake të brinjëzuar, pllake me galeri; Sistemi konstruktiv bartës në përgjithësi (sistemi horizontal, vertikal, lidhjet për shtangësi ); Forma e bazës dhe renditja e shtyllave; Konstruksioni meskatorë-elementet dhe funksioni i tyre në përgjithësi

**Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit::** Studenti të fitoj një dituri të përgjithshme për konstruksionet – ndërtesat metalike. Studenti të fitoj njohuri të mjaftueshme për formimin e konstruksioneve- ndërtesave metalike prej elementeve të ndryshëm si një tërsi. Studenti të zotroj mirë elementet– pjesë të konstruksionit metalik të një ndërtese të lart si dhe mënyren e lidhjeve të këtyre elementeve në mes veti si tërsi. Studenti aftësohet që në mënyrë të pavarur të zgjedhë dispozitën e përgjithëshme të një ndërtese të lartë me konstruksion metalik, analizen e ngarkesave (ngarkesat e përhershme, bora, era, temperatura etj.), sistemin statik të mbajtësve kryesorë me shemen e ngarkimit për rastet më të disfavorshme të mundëshme dhe llogarin statike dhe dimensionimin e elementeve kryesor të konstruksionit bartës.

**Format e mesimdhënies dhe mesim nxënies:** Prezantimi i ligjeratave me kompjuter dhe projektor, shpjegime në tabele, bashkëpunimi i mesimdhënesit me studentin gjatë kohës së ligjerimit përkatësisht ushtrimeve të shembujve numerike duke filluar nga shembujt elementarë deri të shembujt më të nderlikuar të elementeve strukturore prej çelikut. Krahasimi dhe vlerësimi i punimeve të ndryshme, rritja e performancës të projektimit-llogarise. Para fillimit të çdo ligjerate realizohen perseritje me studentet për temat paraprake. Brenda kohës prej 15 javë mesimi organizohen tri kolokiume si teste të nxënies dhe të njëjtat kanë ndikim në vlerësimin përfundimtar.

**Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:** Në formë ligjerate, ushtrimeve numerike, diskutimeve gjatë ligjeratave dhe ushtrimeve grupore si dhe vizita e objekteve të ndryshme në fazën e ndërtimit dhe të përfunduara. Tri nga kolokiumet vlerësohen  $(10+10+10)=30\%$ , Punimi semestral vlerësohet me 20%, Prezenca në ligjerata dhe ushtrime 5%, prezantimi i punimit 5%, pjesa teorike e testit vlerësohet 40%. Kalueshmëria e studentit vlerësohet në përqindje, në varesi nga nxenia gjatë zhvillimit të lëndës. Vlera më e madhe se 50% është rezultat pozitiv.

**Mjetet e konkretizimit/TI;** Tabela, kompjuter, tavolina pune, projekte të ndryshme.

### Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

| Pjesa teorike | Pjesa praktike |
|---------------|----------------|
| 95%           | 5%             |

**Literatura bazë** që shfrytëzohet në lëndë

Konstruksionet e ndërtesave metalike nga prof.dr. Afrim Vokshi  
Konstruksionet e çelikut në ndërtimtari nga autoret(Zaric,Budjevac dhe Stipanic)  
Konstruksionet mikse çelik-beton nga Drago Horvatic`  
Normativat Eurocode 1,2,3 dhe 4

## KONSTRUKSIONET E BETONIT

**Përmbajtja** :Traret e lartë prej betoni të armuar, pllakat rrethore prej betoni të armuar , muret mbrojtëse prej betoni, elementet nën ndikimin e epjes gjatësore,caktimi i përkulshmëris gjatësore, përkulja e pjertë, Gjendja kufitare e shfrytëzimit, kombinimi i ngarkesave më të disfavorshme por të munshëme, gjendja kufitare e nderjeve , gjendja kufitare e plasaritjeve dhe gjendja kufitare e uljeve te elementet e betonit të armuar.Gjendja kufitare e nderjeve , llogaritja e nderjeve sipas EC-2.

**Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit:** Zgjerimi i metejme i njohurive ne fushen e Konstruksioneve prej betoni te fituara nga kurset e më parshme.Te njihen studentet me elementet e konstruksioneve prej betoni dhe dimesionimin e tyre .Aftesimi i studenteve per te llogaritur dhe dimensionue si dhe punimin e detalit të armimit.propozimi i dimensioneve adekuate të elementeve ne mvaresi nga destinimi i objektit. Dimensionon detalet e armimit për elementet e konstruksionit. Trajton problemin e epjes së elementeve që kanë përkulshmëri gjatësore, Analizon dhe llogarite problemin e plasaritjeve te elementet prej betoni të armuar, si dhe të uljeve te elementeve prej betoni të armuar për kohen 0 dhe  $\infty$  sipas EC-2

**Format e mesimdhenies dhe mesim nxenies:** Prezantimi i ligjeratave me kompjuter dhe projektor, shpjegime ne tabele, bashkepunimi i mesimdhenesit me studentin gjate kohes se ligjerimit perkatesisht ushtrimeve te shembujve numerike duke filluar nga shembujt elementare deri te shembujt me te nderlikuar te elementeve struktureore prej betonit. Krahasimi dhe vleresimi i punimeve te ndryshme, rritja e performances te projektimit-llogarise. Para fillimit te cdo ligjerate realizohen perseritje me studentet per temat paraprake. Brenda kohes prej 15 jave mesimi organizohen tri kolokiume si teste te nxenies dhe te njejtat kane ndikim ne vleresim perfundimtare.

**Metodat e vleresimit dhe kriteret e kalueshmerise:** Në formë ligjerate, ushtrimeve numerike, diskutimeve gjatë ligjeratave dhe ushtrimeve grupore si dhe vizita e objekteve të ndryshme në fazën e ndërtimit dhe të përfunduara. Tri nga kolokiumet vleresohen (10+10+10)=30%, Punimi semestral vleresohet me 20%, Prezenca ne ligjerata dhe ushtrime 5%, prezentimi i punimit 5%, pjesa teorike e testit vleresohet 40%. Kalueshmeria e studentit vleresohet ne perqindje, ne varesi nga nxenia gjate zhvillimit te lendes. Vlera me e madhe se 50% eshte rezultat pozitiv.

**Mjetet e konkretizimit/TI;** Tabela, kompjuter, tavolina pune, projekte te ndryshme.

### Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

| Pjesa teorike | Pjesa praktike-elaboratet |
|---------------|---------------------------|
| 50 %          | 50 %                      |

### Literatura bazë:

1. K.Morina, H. Sylejmani- Konstruksionet e betonit ,
2. Vahid Hasanović: Proračun armiranobetonskih konstrukcija,
3. Jure Radići suradnici: Betonske Konstrukcije –Priručnik, Hrvatska sveučilišna naklada, Sveučilište u Zagrebu – Građevinski fakultet, Andris, Zagreb,

## MENAXHIMI I PROJEKTEVE

**Përmbajtja:** Principet themelore të menaxhimit: çka është menaxhimi, kush janë menaxherët zhvillimi i menaxhimit, zhvillimi i menaxhimit, funksionet e menaxhimit. Vendosshmëria punuese; definimi i vendosshmëris, problemet dhe gabimet në vendosje, stilet dhe mënyra e vendosjes metodat e marrjes së vendimit, metodat e parashikimit. Menaxhimi i projektit: definicioni, udhëheqësi i projektit, qëllimet e projektit, llojet e projektit. Përbërja e ekonomisë dhe rrethit të tij; bazat e organizimit të menaxhimit; qëllimet e organizimit, struktura organizative, aspektet teknologjike, ekonomike dhe sociale të organizimit, ndikimi i rrethit në strukturën organizative , specifikat e pjesëmarrësve të punës në ndërtimtari. Planifikimi i procesit punues: natyra, arsyeja dhe qëllimi i udhëheqjes të procesit të planifikimit. Udhëheqja në proceset punuese, stilet dhe mënyrat e udhëheqjes, udhëheqja, motivimi, komunikimi në vendosshmërit punuese, sjellja në punë. Kontrollimi i proceseve punuese: kontrolli financiar e projektit të ndërtimtarisë.

**Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit::** Pas përfundimit të kursit studenti do të jetë në gjendje të njoh, të kuptojë dhe të përdor drejt nocionet themelore të menaxhimit në përgjithësi, si dhe principet kryesore të organizimit dhe menaxhimit të punës në projekte në vecanti , me qëllim që sa më lehtë të përballojë vështirësitë që e presin gjatë dhe pas këtyre studimeve. Menaxhon projektet e strukturave të inkorporuara edhe me fazat tjera të Arkitektures, Makinerisë dhe

**Format e mesimdhënies dhe mesim nxënies:** Prezantimi i ligjeratave me kompjuter dhe projektor, shpjegime në tabele, bashkëpunimi i mesimdhënies me studentin gjatë kohës së ligjerimit perkatesisht ushtrimeve të shembujve të rasteve të ndryshme të punimeve. Krahasimi dhe vlerësimi i punimeve të ndryshme, rritja e performancës të hartimit të një punimi. Para fillimit të çdo ligjerate perseritje me studentet për shtjellimet paraprake. Brenda kohës prej 15 javë mesimi organizohet dy kolokiume si teste të nxënies dhe të njëjtat kanë ndikim në vlerësim përfundimtarë.

**Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:** Dy nga kolokiumet vlerësohen (15+15)=30%, Punimi semestral vlerësohet me 30%, Prezenca në ligjerata dhe ushtrime 10%, prezentimi i punimit 10%, pjesa teorike e testit vlerësohet 20%. Kalueshmëria e studentit vlerësohet në përqindje, në varesi nga nxenia gjatë zhvillimit të lëndës. Vlera më e madhe se 50% është rezultat pozitiv.

### **Mjetet e konkretizimit/TI;**

Tabela, kompjuter, tavolina pune, projekte të ndryshme.

### **Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit**

|               |                           |
|---------------|---------------------------|
| Pjesa teorike | Pjesa praktike-elaboratet |
| 80 %          | 20 %                      |

Literatura bazë: Menadžent za inženjere, Mariza Katavic, Sveučilište u Zagrebu, Građevinski Fakultet, Zagreb 2006. Literatura e propozuar: Management for the Construction Industry, Stephen Lavender, Longman and The Chartered Institute of Building, Essex, England 1996.



## STRUKTURAT PREJ DRURI TË LAMELUAR:

**Permbajtja:**Rregullat themelore për formimin e elementeve të lameluara. Njehsimi i elementeve të veçanta të strukturave prej druri të lameluar. Formimi i strukturave prej drurit të lameluar, lidhet e tyre, vazhdimet montuese, mbështetëset. Stabiliteti i strukturave sistem ram prej druri të lameluar.

**Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit::** Një modul teorik që aftëson studentin për të njohur materialin e drurit të lameluar dhe vetitë e tij për konstruksione, llogaritjen dhe projektimin e konstruksioneve nga druri i lameluar. Llogarit veprimet e jashtme në konstruksionet prej drurit, lexon koeficientet parcial të sigurisë bazuar në EC-1 dhe EC-5. Radhit dhe shpjegon proceset teknologjike të formimit të konstruksioneve të lameluara, veçoritë e konstruksioneve të lameluara si dhe rregullat teknike të formimit të laminateve. Llogarit elemente, sistem statik tra i thjeshtë i lameluar, Llogarit elemente e konstruksioneve tip ram nga druri i lameluar. Llogarit elemente e konstruksioneve ram tip hark nga druri i lameluar. Llogarit mbështetjet e ndryshëm të konstruksionet e lameluara. Projektton dhe llogarit shtangimit e nevojshme të konstruksionit prej druri të lameluar.

**Format e mesimdhënies dhe mesim nxënies:** Prezantimi i ligjeratave me kompjuter dhe projektor, shpjegime në tabele, bashkëpunimi i mesimdhënesit me studentin gjatë kohës së ligjerimit përkatesisht ushtrimeve të shembujve numerike duke filluar nga shembujt elementare deri të shembujt me të ndërlikuar të elementeve strukturore prej drurit të lameluar. Krahasimi dhe vlerësimi i punimeve të ndryshme, rritja e performancës të projektimit-llogaritjes. Para fillimit të çdo ligjerate realizohen perseritje me studentet për temat paraprake. Brenda kohës prej 15 javë mesimi organizohet dy kolokiume si teste të nxënies dhe të njejtat kanë ndikim në vlerësimin përfundimtar.

**Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:** Në formë ligjerate, ushtrimeve numerike, diskutimeve gjatë ligjeratave dhe ushtrimeve grupore si dhe vizita e objekteve të ndryshme në fazën e ndërtimit dhe të përfunduara. Dy nga kolokiumet vlerësohen (15+15)=30%, Punimi semestral vlerësohet me 20%, Prezenca në ligjerata dhe ushtrime 5%, prezentimi i punimit 5%, pjesa teorike e testit vlerësohet 40%. Kalueshmëria e studentit vlerësohet në përqindje, në varësi nga nxënja gjatë zhvillimit të lëndës. Vlera më e madhe se 50% është rezultat pozitiv.

**Mjetet e konkretizimit/TI;** Tabela, kompjuter, tavolina pune, projekte të ndryshme.

### Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

| Pjesa teorike | Pjesa praktike |
|---------------|----------------|
| 60 %          | 40 %           |

**Literatura bazë** që shfrytëzohet në lëndë :

1. F. Grajcevc, Konstruksionet prej druri ,(ligjërata të autorizuar) FNA, Prishtinë
2. Werner, Zimmer., "Holzbau 2", Dach- und Hallentragwerke nach DIN und Eurocode, Berlin Aufl.-1999; Eurocode 1; Eurocode 5

## MATERIALET POLIMERE DHE BITUMINOZE

**Përmbajtja:** Njohuri te përgjithshme per Materialet Polimere. Karakteristikat e veçanta. Llojet e polimerive dhe përdorimi ne elemente konstruktive. Betonet polimere, karakteristikat e veçanta krahasuar me betonet e rendomta. Materialet bituminoze, karakteristikat e tyre dhe ekzaminimet e nevojshme. Asfalti dhe karakteristikat e asfaltit si material.

**Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit::** Te njihen studentet me materialet Polimere dhe Bituminoze, nocionet baze dhe karakteristikat, Mundesine e aplikimit te ketyre materialeve ne permiresimin e vetive te materialeve baze te ndertimit, sic jane: betoni, asfalti etj. Te kenë mundësi qe ne laborator te plotësojnë njohuritë mbi vetitë e ketyre materialeve. te njohë karakteristikat e materileve polimere prejardhjen dhe nocionet baze, te njohë vetitë e materialeve bituminoze dhe sjelljen e tyre ne kushte te veçanta, te dije te përdorë materiale polimere dhe bituminoze ne permiresimin e vetive apo edhe si materiale te veçanta ne inxhinierine e ndertimit, te mund te qaset ne problematiken e zhvillimeve teknologjike te ketyre materialeve bazuar ne Standardet.

**Format e mesimdhënies dhe mesim nxënies:** Prezantimi i ligjeratave me kompjuter dhe projektor, shpjegime ne tabele, bashkepunimi i mesimdhenesit me studentin gjate kohes se ligjerimit perkatesisht ushtrimeve te shembujve numerike duke filluar nga shembujt elementare deri te shembujt me te nderlikuar te strukturave. Krahasimi dhe vleresimi i punimeve te ndryshme, rritja e performances te projektimit-llogarise. Para fillimit te cdo ligjerate realizohen perseritje me studentet per temat paraprake. Brenda kohes prej 15 jave mesimi organizohen dy kolokiume si teste te nxënies dhe te njejtat kane ndikim ne vleresim perfundimtare.

**Metodat e vleresimit dhe kriteret e kalueshmerise:** Në formë ligjerate, ushtrimeve numerike, diskutimeve gjatë ligjeratave dhe ushtrimeve grupore si dhe vizita e objekteve të ndryshme në fazën e ndërtimit dhe të përfunduara. Dy nga kolokiumet vleresohen (15+15)=30%, Punimi semestral vleresohet me 20%, Prezenca ne ligjerata dhe ushtrime 5%, prezentimi i punimit 5%, pjesa teorike e testit vleresohet 40%. Kalueshmeria e studentit vleresohet ne perqindje, ne varesi nga nxenia gjate zhvillimit te lendes. Vlera me e madhe se 50% eshte rezultat pozitiv.

**Mjetet e konkretizimit/TI;** Tabela, kompjuter, tavolina pune, projekte te ndryshme.

### Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

| Pjesa teorike | Pjesa praktike |
|---------------|----------------|
| 60 %          | 40 %           |

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë :

1. N.Kabashi, Materialet polimere dhe bituminoze FNA, Prishtine
- 2/Z.Simunic: Polimeri u graditeljstvo, Zagreb
3. Sergiy Minko: Responsive polymer materials

## METODAT MATEMATIKORE NE INXHINIERI

**Përmbajtja:** Në kuadër të kësaj lënde do të trajtohen:

**Ekuacionet diferenciale:** Ekuacionet diferenciale të rendit të parë, ekuacionet diferenciale të rrethave të larta me theks të veçantë në ekuacionet diferenciale lineare me koeficient konstante dhe zgjidhja numerike e tyre.

**Seritë e pafundme:** Seritë e pafundme numerike. Seritë e pafundme funksionale, seritë polinomiale dhe seritë Fourie si dhe aplikimi i serive në zgjidhjen e ekuacioneve diferenciale.

**Integralet e shumëfishta:** Integralet e dyfishta, integralet e trefishta, zbatimi i integraleve të dyfishta dhe trefishta në lëmin e ndërtimitarisë.

**Integralet vijepërkuarta dhe sipërfaqesore:** Integralet vijepërkuarta, integralet sipërfaqesore dhe aplikimi i këtyre llojeve të integraleve në lëmin e ndërtimitarisë.

**Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit::** që të aftësohen studentët që të zgjidhin detyra nga përmbajtja e lëndës ; që studentët t'i zgjerojnë kompetencat e tyre profesionale duke shfrytëzuar materialin e shtjelluar; që t'i pajisë studentët me njohuri nga lënda në atë nivel që të jenë në gjendje ato njohuri të i aplikojnë në ndërtimtari; që të zhvillohen shkathtësitë në atë nivel që studentët të mund të bëjnë modele matematike të problemeve praktike e më pastaj të i zgjidhin.

Pas përfundimit të kësaj lënde studentë mund të përpilojnë modele matematike nga problemet praktike; t'i zgjidhin modelet matematike; t'i interpretojnë në praktike rezultatet e zgjidhjeve nga modelet matematike.

**Format e mesimdhënies dhe mesim nxënies:** Prezantimi i ligjeratave me kompjuter dhe projektor, shpjegime në tabele, bashkëpunimi i mesimdhënies me studentin gjatë kohës së ligjerimit përkatësisht ushtrimeve të shembujve numerike. Para fillimit të çdo ligjerate realizohen përsëritje me studentet për temat paraprake. Brenda kohës prej 15 javë mesimi organizohet tri kolokiume si teste të nxënies dhe të njejtat kanë ndikim në vlerësim përfundimtarë.

**Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:** Në formë ligjerate, ushtrimeve numerike, diskutimeve gjatë ligjeratave dhe ushtrimeve grupore si dhe vizita e objekteve të ndryshme në fazën e ndërtimit dhe të përfunduara. Tri nga kolokiumet vlerësohen  $(10+10+10)=30\%$ , Punimi semestral vlerësohet me 20%, Prezenca në ligjerata dhe ushtrime 5%, prezentimi i punimit 5%, pjesa teorike e testit vlerësohet 40%. Kalueshmëria e studentit vlerësohet në përqindje, në varesi nga nxënja gjatë zhvillimit të lëndës. Vlera më e madhe se 50% është rezultat pozitiv.

**Mjetet e konkretizimit/TI;** Tabela, kompjuter, tavolina pune, projekte të ndryshme.

**Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit**

| Pjesa teorike | Pjesa praktike |
|---------------|----------------|
| 50%           | 50%            |

**Literatura bazë:**

A.Zejnullahu, F.Berisha: Matematika III 1997 , UP-FNA

Richard L. Burden, J.Douglas Faires: Numerical Analysis, 1997, Brooks/Cole Publishing Company, USA.

Margarita Qirko, Syti Hysko: Analiza Numerike, 2004, Universiteti Politeknik i Tiranës

## METODA E ELEMENTËVE TË FUNDËME

**Përmbajtja:** Përveç trajtimeve të domosdoshme teorike, paraqiten kryesisht bazat fiziko-geometrike e inxhinierike të konceptit dhe teknikës së elementëve të fundëm. Materiali është kufizuar në kuadrin e analizave statike dhe dinamike të strukturave, të cilët në shumë raste ilustrohen me shembuj konkretë. Pjesa e parë ka të bëjë me Bazat teorike me aplikime nga Statika e Strukturave, kurse pjesa e dytë me Dinamikën e Strukturave.

**Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit::** Njohuri bazë mbi MEF dhe aplikime në analizat statike dhe dinamike të strukturave inxhinierike. Pas përfundimit të këtij kursi /lënde mësimore/ studenti do të jetë në gjendje që të njoh, të përdor dhe të kuptojë drejt nocionet themelore të shkencës së ndërtimit në përgjithësi, në fushën e statikës dhe dinamikës së strukturave në veçanti, me qëllim që sa më lehtë të përballojë vështirësitë që e presin gjatë dhe pas këtyre studimeve.

**Format e mesimdhënies dhe mesim nxënies:** Prezantimi i ligjeratave me kompjuter dhe projektor, shpjegime në tabele, bashkepunimi i mesimdhënesit me studentin gjatë kohës së ligjerimit perkatesisht ushtrimeve të shembujve numerike duke filluar nga shembujt elementare deri të shembujt më të ndërlikuar të strukturave. Krahasimi dhe vlerësimi i punimeve të ndryshme, rritja e performancës të projektimit-llogarise. Para fillimit të çdo ligjerate realizohen perseritje me studentet për temat paraprake. Brenda kohës prej 15 javë mesimi organizohet tri kolokiume si teste të nxënies dhe të njëjtat kanë ndikim në vlerësim përfundimtarë.

**Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:** Në formë ligjerate, ushtrimeve numerike, diskutimeve gjatë ligjeratave dhe ushtrimeve grupore si dhe vizita e objekteve të ndryshme në fazën e ndërtimit dhe të përfunduar. Tri nga kolokiumet vlerësohen (10+10+10)=30%, Punimi semestral vlerësohet me 20%, Prezenca në ligjerata dhe ushtrime 5%, prezentimi i punimit 5%, pjesa teorike e testit vlerësohet 40%. Kalueshmëria e studentit vlerësohet në përqindje, në varesi nga nxënja gjatë zhvillimit të lëndës. Vlera më e madhe se 50% është rezultat pozitiv.

### Mjetet e konkretizimit/TI;

Tabela, kompjuter, tavolina pune, projekte të ndryshme.

### Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

| Pjesa teorike | Pjesa praktike |
|---------------|----------------|
| 100%          | 0%             |

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

Musa Stavileci, Niko Pojani: Metoda e elementëve të fundëm në Mekanikën e Strukturave, UP, FNA, Prishtinë, 2006; Wilson E.L.: Three-Dimensional Static and Dynamic Analysis of Structures, Computers and Structures, inc Third Edition, 2002; Zienkiewicz O.: The Finite Element Method, McGraw-Hill, New York, 1994

## PLLAKAT DHE GUASKAT

**Përmbajtja:** Lënda përmban dy pjesë kryesore: teorinë e përkuljes së pllakave të holla dhe teorinë e guackave. Në pjesën e parë përfshihen pllakat drejtkëndëshe dhe pllakat rrethore. Në pjesën e dytë analizohen guaskat rrotulluese, si dhe guaskat cilindrike rrotulluese dhe ato me formë të përgjithshme.

**Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit:** Njoftimi me njohuritë bazë nga fusha e mbajtësve pllakë dhe guackë. Pas përfundimit të kursit studentin do të jetë në gjendje të njoh, të kuptojë dhe të përdor drejt nocionet themelore të shkencës së ndërtimit në përgjithësi, në fushën e mbajtësve pllakë dhe guackë në veçanti, me qëllim që sa më lehtë të përballojë vështirësitë që e presin gjatë dhe pas këtyre studimeve.

**Format e mesimdhënies dhe mesim nxënies:** Prezantimi i ligjeratave me kompjuter dhe projektor, shpjegime në tabele, bashkëpunimi i mesimdhënesit me studentin gjatë kohës së ligjerimit përkatësisht ushtrimeve të shembujve numerike duke filluar nga shembujt elementarë deri të shembujt më të ndërlikuar të strukturave. Krahasimi dhe vlerësimi i punimeve të ndryshme, rritja e performancës të projektimit-llogaritës. Para fillimit të çdo ligjerate realizohen perseritje me studentet për temat paraprake. Brenda kohës prej 15 javë mesimi organizohet tri kolokiume si teste të nxënies dhe të njejtat kanë ndikim në vlerësim përfundimtarë.

**Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:** Në formë ligjerate, ushtrimeve numerike, diskutimeve gjatë ligjeratave dhe ushtrimeve grupore si dhe vizita e objekteve të ndryshme në fazën e ndërtimit dhe të përfunduar. Tri nga kolokiumet vlerësohen  $(10+10+10)=30\%$ , Punimi semestral vlerësohet me 20%, Prezenca në ligjerata dhe ushtrime 5%, prezentimi i punimit 5%, pjesa teorike e testit vlerësohet 40%. Kalueshmëria e studentit vlerësohet në përqindje, në varesi nga nxenia gjatë zhvillimit të lëndës. Vlera më e madhe se 50% është rezultat pozitiv.

**Mjetet e konkretizimit/TI;** Tabela, kompjuter, tavolina pune, projekte të ndryshme.

### Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

| Pjesa teorike | Pjesa praktike |
|---------------|----------------|
| 100%          | 0%             |

**Literatura bazë** që shfrytëzohet në lëndë:

Musa Stavileci: Teoria e sistemeve sipërfaqësore, UP, FNA, Prishtinë, 1997

Stavileci M.: Teoria e sistemeve sipërfaqësore – detyra të zgjidhura, UP, FNA Prishtinë, 1997,

Girkman K.: Flachentragwerke, Wien, 1959

Timoshenko S.: Theory of plates and Shells, New York, 1965

## GJUHA ANGLEZE TEKNIKE I

**Përmbajtja:** Hyrje në lëndën Gjuhe angleze teknike. Inzhinieria e ndërtimit si profesion. Arsytet e zgjedhjes së inzhinjerisë si profesion. Principet kryesore të materialeve të ndërtimit. Krijimi i strukturave moderne. Inzhinjeria ambientale. Urat dhe tunelet. Ndërtimet e larta. Përpilimi i fjalive duke shfrytëzuar fjalorin teknik. Pendat e larta.

**Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit:** Të kontrollohen njohuritë e gjuhës angleze, të fituara në shkollimin paraprak me theks të vecantë në gramatikën e gjuhës angleze. Të përmirësohet dhe të ngritet në një nivel më të lartë gjuha angleze, me një theks të vecantë në gjuhën që përdoret në literaturën profesionale dhe korrespondencën e biznesit. Përdor terminologjinë profesionale bazike në gjuhën angleze teknike, në fushën e ndërtimit, Komunikon deri në atë masë sa të shfrytëzojë literaturën profesionale në gjuhën angleze si dhe burimet nga web-i për studime të mëtutjeshme, Zbaton terminologjinë bazike në fushat e ndërtimit si në atë të konstruksioneve, hidroteknikës, arkitekturës dhe infrastrukturës rrugore.

**Format e mesimdhënies dhe mesim nxënies:** Prezantimi i ligjeratave me kompjuter dhe projektor, shpjegime në tabele, bashkëpunimi i mesimdhënesit me studentin gjatë kohës së ligjerimit përkatësisht ushtrimeve të shembujve numerike duke filluar nga shembujt elementare deri të shembujt më të ndërlikuar të elementeve strukturore prej betonit. Brenda kohës prej 15 javë mesimi organizohet në katër kolokiume si teste të nxënies dhe të njëjtat kanë ndikim në vlerësimin përfundimtar.

**Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:** Në formë ligjerate, ushtrimeve numerike, diskutimeve gjatë ligjeratave dhe ushtrimeve grupore si dhe vizita të objekteve të ndryshme në fazën e ndërtimit dhe të përfunduara. Tri nga kolokiumet vlerësohen  $(10+10+10+10)=40\%$ , Punimi semestral vlerësohet me 20%, Prezenca në ligjerata dhe ushtrime 5%, prezantimi i punimit 5%, pjesa teorike e testit vlerësohet 30%. Kalueshmëria e studentit vlerësohet në përqindje, në varesi nga nxenia gjatë zhvillimit të lëndës. Vlera më e madhe se 50% është rezultat pozitiv.

**Mjetet e konkretizimit/TI;** Tabela, kompjuter, tavolina pune, projekte të ndryshme.

### Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

| Pjesa teorike | Pjesa praktike |
|---------------|----------------|
| 100%          | 0%             |

**Literatura bazë** që shfrytëzohet në lëndë:

- Ligjëratat e ofruara nga vet mesimdhënësi
- Faqe të internetit të programit Building Big, Brantacan, ASCE

## GJUHA TEKNIKE GJERMANE I:

**Përmbajtja:** Kusht për të ndjekur lëndën “Gjermanishtja e teknikës I” është që studentët të kenë njohuri bazike të gjuhës gjermane. “Gjermanishtja e teknikës I” është lëndë praktike që ju mundëson studentëve të njihen me terminologjinë gjermane nga fusha e teknikës, ku krahas leksikut mësohen edhe strukturat gramatikore tipike për komunikimin në profesionet teknike. Qëllim i kësaj lënde është që të zgjerojë njohuritë e studentëve rreth terminologjisë nga fusha e teknikës dhe të zhvillojë kompetencat e tyre të përgjithshme gjuhësore. Studentët do të njihen me gjuhën profesionale të fushës së teknikës, do të njihen me strukturën e teksteve shkencore, do të lexojnë dhe interpretojnë tekste profesionale, si dhe do të njihen edhe me teknikat dhe strategjitë e nevojshme të punës. Gjatë kësaj lënde do të përpunohen tema të ndryshme që janë tipike për këtë fushë profesionale në vendet gjermanofolëse.

**Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit:** “Gjermanishtja e teknikës I” janë: që të aftësohen studentët që të komunikojnë në gjuhën gjermane në fushën e tyre profesionale të teknikës, që studentët t’i zgjerojnë kompetencat e tyre profesionale, që t’i pajisë studentët me strategji që u ndihmojnë atyre të kuptojnë fjalët e panjohura, t’i nxjerrin informatat kryesore nga tekstet shkencore si dhe që të hartojnë vet tekste, si p.sh. raporte apo letra formale, që të zhvillohen shkathtësitë receptive dhe produktive të studentit në fushën e teknikës.

**Format e mesimdhënies dhe mesim nxënies:** Prezantimi i ligjeratave me kompjuter dhe projektor, shpjegime në tabele, bashkepunimi i mesimdhënesit me studentin gjatë kohës së ligjerimit perkatesisht ushtrimeve të shembujve numerike duke filluar nga shembujt elementare deri të shembujt më të ndërlikuar të elementeve strukturore prej betonit. Brenda kohës prej 15 javë mesimi organizohet në katër kolokiume si teste të nxënies dhe të njejtat kanë ndikim në vlerësimin përfundimtar.

**Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:** Në formë ligjerate, ushtrimeve numerike, diskutimeve gjatë ligjeratave dhe ushtrimeve grupore si dhe vizita të objekteve të ndryshme në fazën e ndërtimit dhe të përfunduara. Tri nga kolokiumet vlerësohen  $(10+10+10+10)=40\%$ , Punimi semestral vlerësohet me 20%, Prezenca në ligjerata dhe ushtrime 5%, prezentimi i punimit 5%, pjesa teorike e testit vlerësohet 30%. Kalueshmëria e studentit vlerësohet në përqindje, në varësi nga nxënja gjatë zhvillimit të lëndës. Vlera më e madhe se 50% është rezultat pozitiv.

### Mjetet e konkretizimit/TI;

Tabela, kompjuter, tavolina pune, projekte të ndryshme.

### Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

| Pjesa teorike | Pjesa praktike |
|---------------|----------------|
| 30%           | 70%            |

### Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

- **Steinmetz, Maria/ Dintera, Heiner (2014):** Deutsch für Ingenieure. Ein DaF-Lehrwerk für Studierende ingenieurwissenschaftlicher Fächer

### Literatura shtesë:

- Rosemarie Buhlmann, Anneliese Fearn (2013): Technisches Deutsch für Ausbildung und Beruf: Lehr- und Arbeitsbuch. Europa Lehrmittel, Goethe Institut.
- Peter Giloy, Stephan Kumpf (2000): Deutsch für Techniker.

## DINAMIKA E STRUKTURAVE

**Përmbajtja:** Në aspektin teorik dhe aplikativ trajtohen probleme të llogaritjeve të strukturave inxhinierike (trarë, rama, kapriata) që u nënshtrohen ngarkesave dhe veprimeve të ndryshme dinamike. Problemet paraqiten sipas tri pjesëve “klasike” të Dinamikës së strukturave: sistemet me një shkallë lirie, sistemet me shumë shkallë lirie, sistemet me parametra të shpërndarë.

**Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit:** Formim sa më i mirë inxhinierik me njohuritë bazë të analizës dhe projektimit të strukturave inxhinierike që u nënshtrohen ngarkesave të ndryshme dinamike. Studenti të zotroj mirë analizen e strukturave të larta si dhe të elementeve të perberese të tyre. Pas përfundimit të këtij kursi /lënde mësimore/ studentin do të jetë në gjendje që të njoh, të përdor dhe të kuptojë drejt nocionet themelore të shkencës së ndërtimit në përgjithësi, në fushën e dinamikës së strukturave në veçanti, me qëllim që sa më lehtë të përballojë vështirësitë që e presin gjatë dhe pas këtyre studimeve.

**Format e mesimdhënies dhe mesim nxënies:** Prezentimi i ligjeratave me kompjuter dhe projektor, shpjegime në tabele, bashkëpunimi i mesimdhënesit me studentin gjatë kohës së ligjerimit përkatësisht ushtrimeve të shembujve numerike duke filluar nga shembujt elementare deri të shembujt më të ndërlikuar të strukturave. Krahasimi dhe vlerësimi i punimeve të ndryshme, rritja e performancës të projektimit-llogaritjeve. Para fillimit të çdo ligjerate realizohen perseritje me studentet për temat paraprake. Brenda kohës prej 15 javë mesimi organizohet tri kolokiume si teste të nxënies dhe të njëjtat kanë ndikim në vlerësim përfundimtarë.

**Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:** Në formë ligjerate, ushtrimeve numerike, diskutimeve gjatë ligjeratave dhe ushtrimeve grupore si dhe vizita e objekteve të ndryshme në fazën e ndërtimit dhe të përfunduara. Tri nga kolokiumet vlerësohen (10+10+10)=30%, Punimi semestral vlerësohet me 20%, Prezenca në ligjerata dhe ushtrime 5%, prezentimi i punimit 5%, pjesa teorike e testit vlerësohet 40%. Kalueshmëria e studentit vlerësohet në përqindje, në varesi nga nxënja gjatë zhvillimit të lëndës. Vlera më e madhe se 50% është rezultat pozitiv.

**Mjetet e konkretizimit/TI;** Tabela, kompjuter, tavolina pune, projekte të ndryshme.

### Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

| Pjesa teorike | Pjesa praktike |
|---------------|----------------|
| 100%          | 0%             |

**Literatura bazë** që shfrytëzohet në lëndë:

Niko Pojani: Teoria e strukturave DINAMIKA, shblu, Tiranë, 2002; Stavileci M.: Dinamika e konstruksioneve, leksione të shkruara, UP, FNA, Prishtinë 2000, Clough R., Penzien J.: Dynamics of Structures, McGraw-Hill, 2ndEd 1993; Chopra A.: Dynamics of Structures-Theory and Applications to Earthquake Engineering, Prentice-Hall, New York, 1996



## MENAXHIMI I NDERTIMIT

**Përmbajtja:** Projekti Investiv, Vleresimi i projekteve dhe metodat e planifikimit të ndertimit, Ligjet e ndertimit dhe rregullativa ndertimore, planifikimi dinamik, metoda e rruges Kritike dhe PERT metoda, Kontrolla e ndertimit, Kontrolla e kostove të projektit, Financat në projekt, Teoria e menaxhimit të një projekti, Resurset Humane në Projekt,

**Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësim:** Pas kompletimit të kursit Studenti do të jetë në gjendje të kuptojë elementet e menaxhimit të ndertimit duke filluar nga fazat e projektit, fizibiliteti dhe planifikimi i resurseve në projekt. Element tjetër i këtij kursi është që studentit të jetë në gjendje që të bëjë planifikimin dinamik të projektimit ndertimit si dhe përcjelljen e planeve përgjatë projektimit/ndertimit të një projekti.

**Format e mesimdhënieve dhe mesim nxënies:** Prezentimi i ligjeratave me kompjuter dhe projektor, shpjegime në tabele, bashkëpunimi i mesimdhënesit me studentin gjatë kohës së ligjerimit përkatësisht ushtrimeve të shembujve të rasteve të ndryshme të punimeve. Krahasimi dhe vleresimi i punimeve të ndryshme, rritja e performancës të hartimit të një punimi. Para fillimit të çdo ligjerate përsëritje me studentet për shtjellimet paraprake. Brenda kohës prej 15 javë mesimi organizohet dy kolokiume si teste të nxënies dhe të njëjtat kanë ndikim në vleresim përfundimtarë.

**Metodat e vleresimit dhe kriteret e kalueshmërisë:** Dy nga kolokiumet vlerësohen (15+15)=30%, Punimi semestral vlerësohet me 30%, Prezenca në ligjerata dhe ushtrime 10%, prezentimi i punimit 10%, pjesa teorike e testit vlerësohet 20%. Kalueshmëria e studentit vlerësohet në përqindje, në varësi nga nxënia gjatë zhvillimit të lëndës. Vlera më e madhe se 50% është rezultat pozitiv.

**Mjetet e konkretizimit/TI;** Tabela, kompjuter, tavolina pune, projekte të ndryshme.

### Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

|               |                           |
|---------------|---------------------------|
| Pjesa teorike | Pjesa praktike-elaboratet |
| 50 %          | 50 %                      |

**Literatura bazë :** Kralj D. Construction Management, Halpin W. Daniel Construction Management , fourth edition John Wiley & Sons, Oct 18, 2010.

## URAT

**Përmbajtja:** Lënda shtjellon urat e betonit si struktura ne teresi duke filluar me historine e urave, llojet me te shpeshta te urave, llojet e pengesave dhe kriteriumet për tejkalimin e tyre. Ne vazhdim shtjellohen sistemet statike te mundshme, si dhe llojet e prerjeve terthore, kur dhe cilat preferohen. Pastaj shtjellohen llojet e ngarkesave, te cilat aplikohen sipas EN normave si dhe menyra e dimensionimit te elementeve te ures.

**Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit:** Aftesim bazik per principet e projektimit dhe llogarive te ures. Pas përfundimit të kursit studenti do të jetë në gjendje të njohë, kuptojë dhe të përdorë drejtë elementet themelore të nje ure, te përcjellë realizimin e projektit si dhe te projektojë ura modeste

**Format e mesimdhënies dhe mesim nxënies:** Prezantimi i ligjeratave me kompjuter dhe projektor, shpjegime ne tabele, bashkepunimi i mesimdhenesit me studentin gjate kohes se ligjerimit perkatesisht ushtrimeve te shembujve numerike duke filluar nga shembujt elementare deri te shembujt me te nderlikuar te elementeve strukturore. Krahasimi dhe vleresimi i punimeve te ndryshme, rritja e performances te projektimit-llogarise. Para fillimit te cdo ligjerate realizohen perseritje me studentet per temat paraprake. Brenda kohes prej 15 jave mesimi organizohen tri kolokiume si teste te nxënies dhe te njejtat kane ndikim ne vleresim perfundimtare.

